# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6833
E premte, 24 shkurt 2023
çmimi 0.40 €


## Vendoset gurthemeli për objektet e reja të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KURTI: ALEATËT E KOSOVËS E KANË DIZAJNUAR PLANIN EVROPIAN DHE PËRMBAN NJOHJEN DE-FACTO

FAQE 4-5



Kryeministri i vendit, Albin Kurti, u është përgjigjur të enjten pyetjeve të deputetëve për dialogun me Serbinë dhe takimit që do të mbahet të hënën, më 27 shkurt, në Bruksel. Kurti, duke folur për planin evropian për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi, tha se plani nuk është produkt i negocimit, por shumë më shumë ka të bëjë me historinë prej më shumë se një dekade të dialogut në Bruksel. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se Kosova, duke pranuar planin franko-gjerman, arrin t'i ndalë qëllimet e Rusisë që ka për destabilizimin e Ballkanit

## KUVENDI MIRATON MARRËVESHJEN PËR LËVIZJEN ME LETËRNJOFTIME NË BALLKANIN PERËNDIMOR

FAQE 3



## NJË VIT LUFTË KUNDËR UKRAINËS: DUKE VEPRUAR SË BASHKU PËR TË SIGURUAR QË E DREJTA NDËRKOMBËTARE DO TË MBIZOTËROJË

FAQE 6

Nga Josep BORRELL



## AKTUALE



### MBI 43 000 TË VDEKUR NGA TËRMETET NË TURQI, HETOHEN NDËRTUESIT

F. 2

### PAS BASTISJES SË BANESËS SË ISH-KËSHILLTARIT TË THAÇIT, REAGON KMDLNJ-ja

F. 5

### KËTË VIT NIS ZBATIMI I PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E 4 000 BANESAVE PËR ÇIFTET E REJA

F. 7

## EKONOMI



### KOSOVA SË SHPEJTI ME LEGJISLACION TË RI PËR LEHTËSIMIN DHE NXITJEN E INVESTIMEVE

F. 8

### ATK-ja NIS IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT 'KREDITIMI I TVSH-së'

F. 8

## SPORT



### BALLKANI NUK GABON NË 'RIZA LUSHTA', LLAPI FITON NDAJ DUKAGJINIT

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Mbi 43 000 të vdekur nga tërmetet në Turqi, hetohen ndërtuesit



**Ankara, 23 shkurt** - Ministri i Brendshëm i Turqisë, Suleyman Soylu, ka thënë se numri i të vdekurve pas tërmeteve shkatërruese të këtij muaji ka arritur në 43 556. Sipas Soylu, që nga tërmeti i parë i 6 shkurtit ka pasur edhe 7 930 pasgoditje, ku më shumë se 600 mijë apartamente dhe 150 mijë ndërtesa tregtare kanë pësuar dëme.
Teksa vendi po përshpejton përgatitjet për strehimin e të prekurve nga tërmeti, ministri i Brendshëm ka njoftuar se pas tërmetit tragjik, Turqia do ta zgjerojë hetimin e saj ndaj kontraktuesve të ndërtimit që dyshohet se kanë shkelur rregullat e sigurisë.
Suleyman Soylu konstatoi se deri më tani janë identifikuar 564 të dyshuar, 160 persona janë arrestuar dhe shumë të tjerë janë ende duke u hetuar. "Qytetet tona do të ndërtohen në vendet e duhura, fëmijët tanë do të jetojnë në qytete më të forta. Ne e dimë se me çfarë lloj prove po përballemi dhe do të dalim më të fortë nga kjo", tha ai për transmetuesin shtetëror TRT Haber.
Në më pak se një vit, presidenti Rexhep Tajip Erdogan është zotuar se të ndërtojë shtëpi për të prekurit nga tërmetet. Erdogani ka 20 vjet që është në pushtet dhe në plan është që pas katër muajsh të mbahen zgjedhjet.
Sondazhet e kryera përpara tërmetit zbuluan se ai ishte veçse ishte nën presion nga rritja e kostos së jetesës, e cila mund të përkeqësohet tani që prodhimi bujqësor është penguar nga katastrofa.
Soylu tha se rreth 313 mijë tenda janë ngritur deri më tani, ndërsa është paraparë që 100 mijë shtëpi kontejneri do të vendosen në zonën e tërmetit.
Për të mbrojtur punëtorët dhe bizneset nga pasojat financiare të tërmetit që goditi jugun e vendit, Turqia prezantoi një sistem të përkohshëm të mbështetjes së pagave të mërkurën dhe ndaloi pezullimet nga puna në dhjetë qytete.
Tërmeti me magnitudë 7.8 ballësh i 6 shkurtit shkaktoi dëme të mëdha në qindra mijëra ndërtesa dhe la miliona të pastrehë.
Sipas deklaratës së Erdogan të martën, rreth 865 mijë njerëz janë duke jetuar në tenda, 23.500 në shtëpi kontejnerë dhe 376 mijë janë duke qëndruar në bujtina publike dhe konvikte për studentët jashtë zonës së tërmetit.
Ministri i Urbanizmit i Turqisë, Murat Kurum, ka bërë të ditur se 164 000 ndërtesa, me më shumë se 530.000 banesa, janë shkatërruar apo janë dëmtuar rëndë nga tërmeti. Qeveria turke tashmë ka nisur proceset e kontraktimit për ndërtimin e banesave të reja në zonën e goditur, ka shtuar Kurum.

# Finlanda do t'i dërgojë në Ukrainë tri tanke Leopard 2



**Kiev, 23 shkurt** - Finlanda do t'i dërgojë në Ukrainë tri tanke luftarake Leopard 2, tha të enjten Ministria finlandeze e Mbrojtjes.
Muajin e kaluar Gjermania pranoi t'i dërgojë tanket Leopard 2 në Ukrainë pas një presioni të madh të ushtruar nga Kievi dhe NATO. Dërgimit të këtyre tankeve u kanë dhënë dritën e gjelbër edhe shtetet e tjera anëtare të NATO-s.
Vlera e paketës më të re të ndihmës mbrojtëse të Finlandës për Ukrainën do të arrijë në 160 milionë euro, duke përfshirë tre Leopardët dhe trajnimin e ushtarëve ukrainas në lidhje me përdorimin e tyre, tha ministria.
Në janar Finlanda premtoi miliona dollarë ndihmë ushtarake për Ukrainën, por jo tanke ushtarake.
Finlanda, e cila ndan një kufi 1 300 km me Rusinë, ka pak më pak se 200 tanke Leopard 2.
Tanku Leopard 2 konsiderohet si një nga më të mirët në vendet perëndimore dhe rreth 20 vende aktualisht e përdorin këtë tank.
Ukraina ka kërkuar 300 tanke të tilla dhe thotë se Perëndimi deri më tani ka premtuar se do t'ia dërgojë të paktën 120.
Rusia që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022 ka më shumë tanke sesa Ukraina, por modelet që Moska ka janë shumë inferiore krahasuar me tanket perëndimore.

# Mbi 90 për qind e qytetarëve të BE-së mbështetin ndihmën e bllokut për Ukrainën



**Bruksel, 23 shkurt** - Mbi 90 për qind e qytetarëve të Bashkimit Evropian mbështetin ndihmën humanitare për Ukrainën, 88 për qind e tyre mbështetin strehimin e qytetarëve Ukrainas që ikin nga lufta, ndërsa 77 për qind i mbështetin sanksionet ekonomike të vendosura ndaj Rusisë. Këto janë gjetjet e anketës së Eurobarometrit të Agjencisë evropiane për hulumtimin e opinionit publik, e cila është publikuar të enjten nga Komisioni Evropian.
Sipas kësaj matjeje, 65 për qind e të anketuarve i mbështesin investimet e BE-së për furnizimin e Ukrainës me pajisje dhe armatim ushtarak.
Lufta në Ukrainë ka ndikuar edhe në rritjen e mbështetjes së qytetarëve të BE-së për politikën e përbashkët evropiane të mbrojtjes dhe sigurisë. Këtë e mbështesin 77 për qind e qytetarëve, një rritje prej 16 për qind në krahasim me anketën e njëjtë të zhvilluar gjatë verës së vitit të kaluar.
Po ashtu, 84 për qind e qytetarëve të vendeve anëtare të bllokut e mbështesin tranzicionin energjetik, për zvogëlimin e varësisë nga gazi rus.
Eksportet e gazit natyror rus në BE besohet se do të zvogëlohen për gati 60 miliardë metra kub më 2023 në krahasim me 140 miliardë metra kub vitin e kaluar dhe gati 200 miliardë metra kub në nivelet para pandemisë së koronavirusit.
Pushtimi rus i Ukrainës, që nisi më 24 shkurt 2022, është një prej konflikteve më vdekjeprurëse në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Po ashtu, ka shkaktuar konfrontimin më të madh midis Moskës dhe Perëndimit që prej krizës së raketave kubane të vitit 1962, kur Bashkimi Sovjetik dhe ShBA-ja ishin afër një lufte bërthamore.
Presidenti rus Vladimir Putin luftën në Ukrainë e quan "operacion special ushtarak". Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Gjykimi i liderëve të UÇK-së, Specialja cakton katër seanca për muajin prill



**Hagë, 23 shkurt** - Në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK), e njohur si Gjykata Speciale, në kalendarin e këtij gjykate është bërë me dije se në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit janë caktuar katër seanca për muajin prill.
Një seancë është caktuar për 3 prill, datë e cila është caktuar edhe si datë e fillimit të gjykimit. Po ashtu, seanca janë caktuar edhe për 4 dhe 5 prill, raporton "Betimi për Drejtësi". Ndërsa më 11 prill pritet të fillojnë paraqitjet e provave të prokurorisë, respektivisht dëgjimi i dëshmitarëve.
Të gjitha këto seanca pritet të fillojnë në orën 9:30, por se do të transmetohen me 45 minuta vonesë për publikun.
Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuza, ku këta të fundit ngarkohen për krime lufte.
Më 29 prill 2022 Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit.
Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, ashtu sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor.
Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020. Ata janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë nga nëntori i vitit 2020.

# Kuvendi miraton marrëveshjen për lëvizjen me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 23 shkurt** - Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar të enjten marrëveshjen për lëvizjen e lirë me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor. Marrëveshja pritet të votohet gjatë 23 shkurtit edhe në Këshillin e Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës. Nëse miratohet, e njëjta dërgohet më pas për miratim në Parlamentin e Bosnjë-Hercegovinës. Pas hyrjes në fuqi, ajo do ta mundësojë lëvizjen pa viza të qytetarëve nga Kosova dhe Bosnja. "Në këtë mënyrë Prishtina dhe Sarajeva krijojnë një urë të re institucionale, por sidomos qytetare që është pritur moti", tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas miratimit.
Kjo marrëveshje është një prej tri marrëveshjeve të arritura në Berlin më 3 nëntor 2022 në kuadër të Procesit të Berlinit.
Bosnjë-Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe qytetarët e të dyja shteteve duhet të pajisen me vizë nëse duan të udhëtojnë në shtetet përkatëse.
Më 2014 Kosova vendosi masën reciproke sa i përket regjimit të vizave për shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës.
Regjimi i vizave ka penguar udhëtimet e qytetarëve që jetojnë në Kosovë, por që kanë prejardhje nga Bosnja. "Radio Evropa e Lirë" vitin e kaluar solli rrëfimet e disa qytetarëve të cilët thanë se po presin që të ndodhë heqja e vizave, pasi kjo do të nënkuptonte për ta "fundin e agonisë".
Vitin e kaluar gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor arritën edhe marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe atë për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe arkitektëve.
Të dyja këto marrëveshje u ratifikuan më 23 shkurt në Kuvendin e Kosovës.

# Osmani i dha mirënjohje Shoqatës së Kosovës për Kërkim-Shpëtim për aksionin humanitar në Turqi



Prishtinë, 23 shkurt - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim Shoqatën e Kosovës për Kërkim-Shpëtim, së cilës ia ka dhënë një mirënjohje për kontributin vullnetar në operacionin humanitar në Republikën e Turqisë pas tërmetit që goditi këtë shtet. Në takim me vullnetarët e kësaj shoqate, presidentja Osmani çmoi lart kontributin e tyre, duke potencuar se ata kanë përfaqësuar denjësisht shpirtin solidar e human të të gjithë qytetarëve të Kosovës.



# Kurti: Aleatët e Kosovës e kanë dizajnuar plani evropian dhe përmban njohjen de-facto

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, i është përgjigjur të enjten pyetjeve të deputetëve për dialogun me Serbinë dhe takimit që do të mbahet të hënën, më 27 shkurt në Bruksel. Kurti duke folur për planin evropian për normalizimin e raporteve Kosovë-Serbi tha se plani nuk është produkt i negocimit por shumë më shumë ka të bëjë me historinë prej më shumë se një dekade të dialogut në Bruksel. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se Kosova duke pranuar planin franko-gjerman, arrin për t'i ndalë qëllimet e Rusisë që ka për destabilizimin e Ballkanit

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se propozimi evropian nuk është produkt i negocimit, meqenëse sipas tij më 18 gusht të vitit të kaluar është hapur tema për kornizën e përgjithshme të marrëveshjes, por pa pasur takime për atë temë, "ku pala tjetër nuk ka qenë e interesuar e as e gatshme për këtë, dhe tri javë pas atij takimi vjen propozimi".

Ai i bëri këto deklarata të enjten në Kuvendin e Kosovës, kur u pyet për temat që pritet të diskutohen në takimin e së hënës me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Pra, nuk është se ne kemi negociuar dhe është sjellë propozimi. Propozimi shumë më shumë ka të bëjë me historinë prej më shumë se një dekade të dialogut të Brukselit. Pra, propozimi nuk është as produkt i përfshirjes së kërkesave negociuese të palëve", ka thënë ai.

Sipas tij, aleatët e Kosovës e kanë dizajnuar propozimin evropian si një pako që do të avancojë anëtarësimin e Kosovës në sistemin ndërkombëtar, "dhe i cili përmban njohjen de-facto, e gjithë kjo bazuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, e cila përbën një kushtetutë të sistemit ndërkombëtarë pas Luftës së Dytë Botërore për marrëdhëniet mes shteteve të pavarura".

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj në seancën e Kuvendit ka thënë se Kosova duke pranuar planin franko-gjerman, arrin për t'i ndalë qëllimet e Rusisë që ka për destabilizimin e Ballkanit.

Ai ka thënë se për këtë të hënën kur është edhe takimi i nivelit të lartë mes kryeministrit Kuti dhe presidentit serb Vuçiq duhet të mbyllet marrëveshja. "I vetmi vend në botë që s'i konvenon marrëveshja është Rusia. Është vendi i vetëm Rusia i cili nuk e dëshiron një marrëveshje në mes Kosovës dhe Serbisë, sepse ata kanë dëshirë që kjo çështje të mbetet e hapur, qoftë për ta destabilizim, qoftë për ta përdorur si shembull. Të hënën mundet me e mbyllë marrëveshjen, jo vetëm me dhënë sinjale pozitive", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se përpos aspektit të sigurisë dhe mbrojtjes, Kosova duhet ta fusë në marrëveshje edhe komponentën financiare në mënyrë që të ndalen rrjedhjet buxhetore në veri të vendit. "Përveç zotimeve politike dhe të sigurisë që Kosova merr në marrëveshje është me rëndësi trajtimi serioz i pakos financiare". "Kosova nuk mbledh tatim në veri të vendit, ndërsa ka edhe elemente tjera që e vështirësojnë situatën buxhetore të Kosovës në raport me veriun. Unë besoj shumë që është një moment i mirë që kryeministri i Kosovës ti kërkon Amerikës dhe BE-së edhe ndihmë financiare por edhe investime por edhe përkrahje ekonomike, për të zbatuar rendin dhe ligjin në veri, por edhe zhvillimin ekonomik por pa rrjedhje të vazhdueshme buxhetore të Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Bashkimi Evropian ka thënë se temë e diskutimit në takimin e nivelit të lartë Kurti-Vuçiq do të jetë propozimi evropian për normalizimin e plotë të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë.

Propozimi evropian u është dorëzuar palëve në shtator të vitit të kaluar, të cilat e kanë konfirmuar se e pranojnë këtë dokument, por ai nuk është bërë publik.

Megjithatë, aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektimi i integritetit territorial, paprekshmëria e kufijve, njohja e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Kurti dhe Vuçiq nuk kanë zhvilluar takim në kuadër të dialogut të Brukselit që nga nëntori i vitit 2022.

Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian më 2011. Palët kanë synime të ndryshme sa i përket marrëveshjes finale, që synohet të arrihet në këtë proces. Kosova insiston në njohje reciproke, ndërkaq Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

# Pas bastisjes së banesës së ish-këshilltarit të Thaçit, reagon KMDLNj-ja

PRISHTINË, 23 SHKURT - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar në lidhje me bastisjen e banesës që i është bërë ish-këshilltarit të ish-presidentit Hashim Thaçi, Adil Behramaj, nga policë dhe hetues të EULEX-it dhe të Gjykatës Speciale të mërkurën.

Sipas KMDLNj-së, bastisja u bë me urdhër të gjykatësit të procedurës paraprake dhe këtë bastisje e bënë hetues dhe policë të pauniformuar, me rroba civile, ndërkaq policët e Policisë së Kosovës siguronin objektin ku bëhej bastisja, pa pasur asnjë qasje në lokacionin e bastisjes.

Sipas informatave të KMDLNj-së, bastisja ka qenë jashtëzakonisht e hollësishme, pa lënë vend pa kontrolluar. "Gjithashtu, sipas informatave të KMDLNj-së, gjatë bastisjes nuk janë shkaktuar dëme materiale dhe as nuk është përdorur asnjë lloj force, as fizike e as psikike. Hetuesit dhe policët civilë kanë pasur autorizim dhe leje për bastisje me të cilën janë njoftuar avokati i autorizuar sikur edhe z. Behramaj, që nënkupton se janë përfillur të gjitha procedurat ligjore dhe se në rastin konkret, nuk mund të flitet për tejkalim të autorizimeve ligjore apo shkelje të të drejtave të njeriut. Pas bastisjes është bërë regjistrimi dhe përpiluar lista e materialeve të konfiskuara siç edhe e parasheh procedura ligjore", është thënë komunikatën e KMDLNj-së.

KMDLNj ka theksuar se bastisja e banesës së Adil Behramajt, ish-këshilltar i ish-presidentit Thaçi, paraqet vazhdimësi të bastisjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ngushtë të presidentit të arrestuar, Hashim Thaçi, e që është një presion për faktin se shumica e tyre, në një mënyrë apo tjetër, janë angazhuar në ekipin mbrojtës të ish-presidentit Thaçi. "Disa prej tyre janë marrë në pyetje në cilësinë e të dyshuarit, ka edhe aktakuza të ngritura dhe fitohet përshtypja e një fushate frikësimi, përmes presionit dhe kërcënimit, për ta pamundësuar apo për ta zvogëluar mundësinë e mbrojtjes. Në anën tjetër, po këta hetues dhe po kjo gjykatë nuk lë asnjë gur pa lëvizur për të siguruar dëshmitarë (qoftë edhe të rrejshëm në mesin e tyre edhe nga radhët e policisë, ushtrisë dhe paramilitarëve të Serbisë) si dhe material akuzues të sajuar nga Prokuroria e Serbisë gjë që krijon të gjitha kushtet për një gjykim të padrejtë, të pabarabartë dhe të ndikuar politikisht dhe grupet e interesit. Bastisja e një udhëheqësi të një mediumi social pikërisht tani dhe në prag të fillimit të gjykimit lehtësisht mund të kuptohet si porosi kërcënuese ndaj të gjithëve që nuk ndajnë mendimin me mënyrën dhe punën që e bënë kjo gjykatë. Aq më parë që liria e shtypit, e shprehjes është e garantuar me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për faktin se është e drejtë elementare e njeriut", theksohet në komunikatën e KMDLNj-së.



Sipas KMDLNj-së, çdo i arrestuar ka të drejtë për një mbrojtje efektive para gjykatës që nënkupton edhe avokatët për të cilët përcaktohet vet, për ekipin mbështetës ku janë të përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme, për ish-bashkëpunëtorë sikur edhe për njohës të të drejtave të njeriut. "Po të njëjtat të drejta i ka edhe pala e dëmtuar, viktima. Duke krijuar këtë baraspeshë të përfaqësimit dhe të drejtave midis të të akuzuarit dhe viktimave, krijohen kushtet për një proces të drejtë, fer dhe të paanshëm. Ndërkaq, marrja në pyetje, akuzimi, kërcënimi, ngritja e aktakuzave për ish-këshilltarët dhe ish-bashkëpunëtorët, në rastin konkret të presidentit Thaçi e prishë këtë barazi dhe i pakëson të drejtat e të arrestuarit për një mbrojtje efektive. Askush nuk duhet dhe nuk mund të përndiqet për shkak të një të kaluare apo aktivitetit politik e që ndërlidhet me kohën kur ishte presidenti aktual në pozitë përveç nëse ka dëshmi të pakundërshtueshme për përfshirje në ndonjë aktivitet që sanksionohet me ligjet në fuqi. Për këtë fjalën e fundit dhe përgjegjësinë e vetme e ka gjykata kompetente, pas një vendimi të formës së prerë.

Informimi i drejtë nuk e pengon asnjë proces gjyqësor, përkundrazi vetëm sa i ndihmon. Në rastin konkret, çdo përpjekje për frikësim apo shantazhim të z. Behramaj për shkak të aktivitetit informativ (nëse është kjo arsyeja e bastisjes) konsiderohet si i papranueshëm, i dënueshëm dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut", theksohet në komunikatën e KMDLNj-së.

KMDLNj ka thënë tutje se Gjykata Speciale këtë e ka përkthyer në një vepër: pengimi i drejtësisë, blerje, ndikim dhe frikësim i dëshmitarëve dhe, mbi këtë bazë, përndiqen të gjithë ata që e kanë pasur një të kaluar të përbashkët politike me të arrestuarit. "Në bazë të monitorimit të punës së Gjykatës Speciale, që nga intervistimi e deri te shqiptimi i dënimit, KMDLNj konstaton se vetëm një numër i vogël i të intervistuarve e bënë publike intervistimin dhe cilësinë në të cilën është ftuar, dëshmitar, i dyshuar apo si viktimë", thuhet në komunikatën e KMDLNj-së.

# Bideni: Putini bëri gabim të madh që pezulloi traktatin për armët bërthamore

VARSHAVË, 23 SHKURT- Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se homologu i tij rus, Vladimir Putin, bëri "gabim të madh" kur një ditë më parë njoftoi se Rusia po pezullonte pjesëmarrjen në traktatin e armëve bërthamore New START.

Biden i bëri këto komente për gazetarët teksa arriti në pallatin presidencial në Varshavë, ku do të marrë pjesë në samitin e nëntë shteteve të Evropës Lindore.

Ky samit, ku marrin pjesë disa shtete të NATO-s, po zhvillohet në ditën e dytë të vizitës së Bidenit në Poloni.

I ashtuquajturi Grupi i nëntë i Bukureshtit përfaqëson vendet që përbëjnë krahun lindor të NATO-s. Aty bëjnë pjesë: Polonia, Rumania, Bullgaria, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Estonia, Letonia dhe Lituania.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjithashtu do të marrë pjesë në takim.

Vizita e Bidenit në Poloni është pjesë e një serie të konsultimeve me aleatët për t'u përgatitur për një fazë më të ndërlikuar të pushtimit rus të Ukrainës, që ka nisur pothuajse një vit më parë.

Gjatë fjalimit të tij të djeshëm para qytetarëve të mbledhur jashtë Keshtjellës Mbretërore në Varshavë, ai tha se Ukraina "kurrë nuk do të jetë një fitore për Rusinë".

Para Polonisë, ai vizitoi Ukrainën, ku qëndroi mbi pesë orë.

Vizita e paparalajmëruar atje nënvizoi edhe një herë bështetjen e Uashingtonit për Kievin.

Biden paralajmëroi Rusinë se nëse sulmon ndonjë shtet të NATO-s, do të përballej me një përgjigje të fuqishme ushtarake.



# Një vit luftë kundër Ukrainës: duke vepruar së bashku për të siguruar që e drejta ndërkombëtare do të mbizotërojë



Nga Josep BORRELL

24 shkurti 2022 do të kujtohet përgjithmonë si dita kur Rusia filloi pushtimin e saj brutal, të paprovokuar dhe të paligjshëm të Ukrainës. Ky ishte dhe mbetet një rast agresioni i pastër dhe një shkelje e qartë e Kartës së OKB-së. Kjo luftë nuk është as 'vetëm një çështje evropiane', as nuk ka të bëjë me 'Perëndimi kundër pjesës tjetër'. Ajo ka të bëjë me llojin e botës në të cilën të gjithë ne duam të jetojmë: askush nuk është i sigurt në një botë ku përdorimi i paligjshëm i forcës nga një fuqi bërthamore dhe anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit do të "normalizohej" deri diku. Kjo është arsyeja pse e drejta ndërkombëtare duhet të zbatohet kudo për t'i mbrojtur të gjithë nga politikat e pushtetit, shantazhet dhe sulmet ushtarake.

Një vit më pas, ekziston rreziku që njerëzit të mësohen me imazhet e krimeve të luftës dhe mizorive që shohin, sepse janë aq të shumta, saqë fjalët që përdorim fillojnë të humbasin domethënien e tyre, sepse na duhet t'i përsërisim aq shpesh, saqë lodhemi dhe dobësojmë vendosmërinë tonë dhe sepse koha po kalon dhe detyra që kemi përpara është e vështirë.

Këtë nuk mund ta bëjmë. Sepse çdo ditë Rusia vazhdon të shkelë Kartën e OKB-së, duke krijuar një precedent të rrezikshëm për gjithë botën me politikën e saj imperialiste. Çdo ditë, Rusia vazhdon të vrasë gra, burra dhe fëmijë të pafajshëm ukrainas, duke hedhur raketa mbi qytetet dhe infrastrukturën civile. Çdo ditë Rusia vazhdon të përhapë gënjeshtra dhe trillime.

Për Bashkimin Evropian dhe partnerët tanë nuk ka alternativë ndaj qëndrimit në kursin e 'strategjisë sonë të trefishtë': mbështetjen e Ukrainës, presionin mbi Rusinë për të ndaluar agresionin e saj të paligjshëm dhe ndihmën për pjesën tjetër të botës që të përballet me pasojat.

Kjo është ajo që kemi bërë për një vit dhe me sukses. Kemi miratuar sanksione të paprecedentë, kemi ndërprerë varësinë tonë nga lëndët djegëse fosile ruse, dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët kryesorë reduktuam me 50% të ardhurat nga energjia që Kremlini merr për të financuar agresionin e vet. Duke punuar së bashku, kemi zbutur gjithashtu efektet globale domino me rënien e çmimeve të ushqimit dhe energjisë, pjesërisht falë Korsive tona të Solidaritetit dhe Nismës për Drithërat në Detin e Zi.

Nuk mjafton të themi se duam që Ukraina të jetë në gjendje të mbrohet vetë - ajo ka nevojë për mjete për ta bërë këtë. Prandaj, për herë të parë, BE-ja ka furnizuar me armë një vend të sulmuar. Në të vërtetë, BE-ja është tani ofruesi kryesor i trajnimit ushtarak për personelin ukrainas, në mënyrë që ata të mund të mbrojnë vendin e tyre. Ne po ofrojmë gjithashtu ndihmë të konsiderueshme makro-financiare dhe humanitare për të mbështetur popullin ukrainas. Dhe kemi vendosur t'i përgjigjemi pozitivisht kërkesës së Ukrainës për t'u anëtarësuar në BE. Së fundi, po punojmë për të siguruar vënien para përgjegjësisë për krimet e luftës që ka kryer Rusia.

Ukraina ka treguar qëndrueshmërinë e saj të jashtëzakonshme, pjesërisht falë kësaj mbështetjeje. Dhe Rusia është bërë më e izoluar, falë sanksioneve globale dhe dënimit ndërkombëtar nga shumica dërrmuese e shteteve në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Qëllimi ynë kolektiv është dhe mbetet një Ukrainë demokratike që triumfon, duke e përzënë pushtuesin, duke rivendosur sovranitetin e saj të plotë dhe, me këtë, duke rivendosur ligjshmërinë ndërkombëtare.

Mbi të gjitha, ne duam paqe në Ukrainë, një paqe gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që është në përputhje me Kartën e OKB-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Mbështetja e Ukrainës dhe puna për paqen shkojnë krah për krah.

Revizionizmi agresiv i Rusisë dhe lëvizjet e saj më të gjera destabilizuese janë një kërcënim global, që prek Ballkanin Perëndimor dhe vendet e Partneritetit Lindor. Ne kemi parë efektet e makinës propagandistike të Rusisë që përpiqet të nxisë trashëgiminë e së kaluarës, si dhe shohim përpjekje në shkallë industriale për manipulimin e informacionit dhe ndërhyrjen e huaj. Kjo është arsyeja pse BE-ja po punon me partnerët, veçanërisht me vendet anëtare të ardhshme, për t'iu kundërvënë këtij kërcënimi. Një pjesë kyçe e kësaj është edhe mbështetja e lirisë së medias dhe pluralizmit politik. Ne po rrisim gjithashtu mbështetjen tonë për përpjekjet për zgjidhjen e konflikteve në Kaukazin e Jugut.

Më gjerësisht, pushtimi rus ka nënvizuar edhe një herë se vendet dhe njerëzit duhet të jenë të lirë të përcaktojnë të ardhmen e tyre. BE-ja e ka bërë të qartë se jemi të gatshëm t'i përgjigjemi dëshirës së partnerit tonë dhe të integrojmë Ballkanin Perëndimor, Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë në Bashkimin tonë dhe po punojmë shumë për ta bërë këtë qëllim realitet. Kjo do të thotë të punojmë së bashku për të ndërtuar shoqëri dhe ekonomi më elastike dhe gjithëpërfshirëse, të zhvillojmë dhe mbrojmë demokracitë tona, si dhe të forcojmë kohezionin social.

Historia dhe drejtësia janë në anën e Ukrainës. Por për të përshpejtuar historinë dhe për të arritur drejtësinë, ne duhet të përforcojmë 'strategjinë tonë të trefishtë'. Ne e dimë se kjo është një detyrë kolektive. Kjo është arsyeja pse BE-ja po mbështetet te të gjithë partnerët e saj për të vepruar me frymën e përgjegjësisë dhe solidaritetit të përbashkët: për të siguruar që agresioni të dështojë dhe e drejta ndërkombëtare të mbizotërojë.



## BKS-ja: Rritje e frikshme e kërkesave për kompensim të dëmeve të lehta

**Prishtinë, 23 shkurt** - Vetëm gjatë vitit 2022 numri i kërkesave për kompensim të dëmeve të lehta në kompanitë e sigurimeve si dhe në Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS) ka arritur në 11 944. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i kërkesave për kompensim të dëmeve të lehta të shkaktuara në aksidente komunikacioni është më i lartë për 11,97 për qind. Ekzistojnë dyshime të bazuara se persona të papërgjegjshëm, duke inskenuar aksidente, përfitojnë jashtëligjshëm, duke iu shkaktuar dëme të konsiderueshme kompanive të sigurimeve si dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Drejtori i BKS-së, Sami Mazreku, ka treguar se rritja e rasteve nuk ka të bëje me mospunën e institucioneve, respektivisht Policisë së Kosovës, por ka të bëjë me rritjen e numrit te personave të papërgjegjshëm të cilët tentojnë të përfitojnë jashtëligjshëm. "Në vazhdimësi kemi rritje të kërkesave për kompensim të dëmeve të lehta. Tashmë ne i kemi identifikuar personat dhe i kemi njoftuar organet e rendit. Demi që na shkaktohet neve vazhdon të jetë shumë i madh", ka thënë drejtori Mazreku.



# Vendoset gurthemeli për objektet e reja të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore

Bashkimi Evropian dhe Universiteti i Prishtinës të enjten kanë vendosur gurthemelin për ndërtimin e objekteve të reja për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, për të cilat do të investohen 13.9 milionë euro

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 23 shkurt** - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog dhe rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), prof. dr. Qerim Qerimi, shënuan të enjten fillimin e ndërtimit të objekteve të reja për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore (FSHMN).

Ambientet do të akomodojnë më shumë se 2 300 studentë dhe 133 anëtarë të stafit që studiojnë, hulumtojnë dhe punojnë në pesë departamente të ndryshme duke përfshirë matematikën, fizikën, kiminë, biologjinë dhe gjeografinë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama dhe personalitete të tjera morën pjesë në ceremoninë e vënies së gurthemelit së bashku me drejtoreshën e Zyrës së UNOPS Austria, Freya von Groote.

UNOPS-i do t'i zbatojë punët e financuara nga BE-ja dhe UP-ja. "Këto objekte të reja do të kontribuojnë në modernizimin e mëtutjeshëm të arsimit të lartë në Kosovë, do t'i rritin kapacitetet kërkimore të studentëve dhe komunitetit akademik dhe do ta promovojnë barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen dhe mirëdashjen mjedisore me laboratorët e tij të pajisur mirë, dhomat për gjidhënie, hapësirat e jashtme të përbashkëta dhe veçori të kursimit të energjisë", ka thënë rektori Qerimi.

Ndërtimi i objekteve të reja të fakultetit, me vlerë 8.9 milionë euro, është pjesë e një programi më të gjerë të BE-së për punësim dhe arsim dhe është një nga projektet e shumta të infrastrukturës arsimore të financuara nga BE-ja në Kosovë.

Derisa BE-ja do ta bëjë ndërtimin e objekteve, Universiteti i Prishtinës do ta furnizojë atë me mobilie dhe pajisje laboratorike në vlerë prej 5 milionë eurosh. "Ky është edhe një investim i BE-së në arsimin e Kosovës. Nga viti 2007 deri në vitin 2022 BE-ja ka investuar 85 milionë euro në zhvillimin e sistemit arsimor në Kosovë për të ndihmuar në krijimin e mundësive për studentët dhe akademinë në Kosovë të ngjashme me ato në BE, dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të udhëhequr nga njohuritë si dhe krijimin e vendeve të punës", ka thënë ambasadori Szunyog.

Duke folur në këtë ngjarje, kryeministri Kurti ka thënë se sot po e bëjnë edhe një hap të rëndësishëm për krijimin e parakushteve për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit në Kosovë. "Ndërtimi i objektit të ri modern për Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Prishtinës do t'u sigurojë studentëve dhe personelit akademik infrastrukturën, teknologjinë dhe resurset e nevojshme për zhvillim akademik dhe profesional në degët studimore të këtij fakulteti. Uroj që gurthemeli që po e vëmë sot të jetë edhe një faqe e re në historinë e zhvillimit të Universitetit të Prishtinës", ka thënë Kurti.

Ky ndërtim i objekteve, i financuar përmes IPA II, po udhëhiqet dhe zbatohet nga UNOPS-i, i cili mban llogaridhënien dhe mbikëqyrjen përfundimtare mbi të gjitha aspektet e menaxhimit të projektit dhe rezultateve të tij. I gjithë procesi që nga planifikimi, dizajnimi dhe menaxhimi i projektit zbatohet dhe udhëhiqet nga UNOPS. "Me vënien e themeleve të Fakultetit të Matematikës dhe Shkencave Natyrore, ne jo vetëm që vendosim themelet për hapësira të reja, por edhe për mundësi dhe shanse të reja për brezat e ardhshëm. Në UNOPS jemi krenarë që jemi pjesë e këtij projekti vizionar dhe presim me padurim për ta dëshmuar impaktin pozitiv të tij në komunitet", ka thënë von Groote e UNOPS-it.

Punimet e ndërtimit pritet të përfundojnë deri në qershorin e vitit 2024.



## Këtë vit nis zbatimi i projektit për ndërtimin e 4 000 banesave për çiftet e reja

**Prishtinë, 23 shkurt** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të enjten në Kuvend se gjatë këtij viti do të fillojë së zbatuari projekti për ndërtimin e 4 000 banesave për çiftet e sapomartuara. Para deputetëve, Kurti ka thënë se projekti për banim të përballueshëm është unik dhe krejtësisht i ndryshëm prej banesave për raste sociale që veçse ekzistojnë në Kosovë.

Ai bëri me dije se projekti mund të kushtojë rreth 200 milionë euro.

Kreu i ekzekutivit gjithashtu tregoi se është miratuar kredia prej 25 milionë eurosh nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës dhe shpejt pritet të vijë në Kuvend si projektligj dhe marrëveshje. "Projekti për banim të përballueshëm është projekt unik dhe zbatohet për herë të parë në Kosovë. Duhet të theksohet se ky projekt është krejtësisht ndryshe prej banesave për rastet sociale që veç ekzistojnë në një masë në Kosovë e që për këtë është aprovuar kredia prej 25 milionë eurosh nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës dhe shumë shpejt pritet të vijë në Kuvend si projektligj dhe marrëveshje", ka thënë Kurti.

Ai u shpreh se varen nga komunat për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim për banesat, ndërsa tha se deri tash janë siguruar lokacione në Prishtinë, Pejë dhe Gjilan. "Projekti është kompleks dhe po zbatohet për herë të parë në Kosovë. Kërkon ekspertizë për implementim të qëndrueshëm. Si qeveri do të bëjmë të pamundurën që projekti i planifikuar të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur", ka theksuar kryeministri Kurti.



## Kroacia pritet ta ndalojë punën të dielave, ka përjashtime për disa lloje të bizneseve

ZAGREB, 23 SHKURT - Qeveria e Kroacisë e ka dërguar në parlament propozimin për ndryshimin e Ligjit për Tregtinë, që parasheh mbylljen e dyqaneve gjatë të dielave.
Në këtë ligj, i cili parashikohet të hyjë në fuqi më 1 korrik, thuhet se tregtarët mund të zgjedhin 16 të diela në vit gjatë të cilave mund të punojnë.
Sipas ministrit kroat për Zhvillim, Davor Filipoviq, orari i punës në këto biznese do të rregullohet në atë mënyrë që të mbyllen të dielave dhe kur ka ditë pushimi gjatë festave. Sa i përket mundësisë së punës gjatë të dielave, projektligji parashikon 16 javë punë gjatë gjithë vitit.
Gjithashtu, përjashtime i referohen blerjes së produkteve parësore të bujqësisë, shitjes së produkteve bujqësore në stenda në tregjet me pakicë e shumicë, shitjet e rastësishme në panaire dhe ato në distancë. Kioskat mund të qëndrojnë të hapura të dielave dhe festave nga ora 07:00 deri në orën 13:00.



# Kosova së shpejti me legjislacion të ri për lehtësimin dhe nxitjen e investimeve



PRISHTINË, 23 SHKURT - Për të diskutuar lidhur me Projektligjin për Investimet e Qëndrueshme dhe nismat e tjera ligjore dhe strategjike të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane ka organizuar një tryezë dialogu me ministren Rozeta Hajdari.
Ministrja Hajdari ka thënë se krahas zhvillimit të akteve të reja ligjore që do ta rregullonin çështjen e investimeve të brendshme dhe të jashtme, Ministria e Tregtisë është angazhuar edhe për zhvillimin e strategjisë industriale, duke e parë këtë si shumë të rëndësishme për orientimin e zhvillimit të industrive të ndryshme në vend, meqë kjo ka munguar deri më tani në vend.
Ajo i njoftoi bizneset e pranishme për risitë e legjislacionit që synon promovimin e investimeve me theks në lehtësimin e nxitjes së investimeve dhe krijimin e një mjedisi të barabartë për investitorët e jashtëm dhe të brendshëm.
Ministrja Hajdari ka thënë se synohet ndarja e agjencisë aktuale në një agjenci e cila do të vazhdojë t'i përkrahë ndërmarrjet si dhe në agjencinë e re për lehtësimin dhe nxitjen e investimeve që do të vendoset në kuadër të zyrës së kryeministrit.
Bizneset e pranishme përgëzuan Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për qasjen proaktive, por edhe ofruan komentet kryesore me qëllim të krijimit të një ligji i cili adreson të metat e akteve paraprake ligjore dhe rekomandimeve të investitorëve, në këtë fazë kur projektligji do të diskutohet më tej në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

# ATK-ja në implementim të projektit "Kreditimi i TVSh-së"

PRISHTINË, 23 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të obliguar të regjistrohen, mbajnë dokumentacion, deklarojnë dhe të paguajnë saktë detyrimet tatimore.
Bazuar në Planin Strategjik 2022-2026 dhe Planin e Trajtimit të Rreziqeve për vitin 2023, ATK-ja ka hartuar planin e veprimit për ta përmirësuar përmbushjen tatimore të personave të tatueshëm të regjistruar për TVSh, përfshirë të gjithë faktorët me ndikim në kreditimin e TVSh-së. Përmes këtij plani, ATK-ja do të kryejë aktivitete intensive me qëllim të identifikimit të personave të cilët nuk deklarojnë saktë kreditimin e TVSh-së.
Administrata Tatimore e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë personave të tatueshëm që t'i përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor, gjegjësisht të deklarojnë dhe paguajnë saktë tatimin; mbajnë dokumentacionin sipas ligjit; deklarojnë saktë furnizimet duke aplikuar saktë normën e TVSh-së; zbritjen e TVSh-së ta bëjnë saktë sipas Ligjit të TVSh-së; aplikojnë ngarkesën e kundërt për TVSh-në ashtu siç kërkohet me ligj etj.




Administrata Tatimore e Kosovës ua ka inkurajuar të gjithë personave fizikë afaristë dhe personave juridikë t'u përgjigjen saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor.
Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

## Mbi 174 mijë familje përfituan në janar nga subvencionimi i energjisë



PRISHTINË, 23 SHKURT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije të hënën se janë procesuar pagesat e subvencionimit të energjisë për të gjitha familjet që e kanë kursyer atë në muajin janar. Murati ka thënë se janë 174 642 familje që kanë shpenzuar më pak energji elektrike sesa në janarin e vitit 2022, rrjedhimisht duke përfituar nga subvencioni. "Shumë familje kanë paguar më pak se kurdoherë për faturat e energjisë elektrike gjatë muajve të dimrit", është shprehur Murati.

# Interneti është makthi i Vrapuesit në Teh, por është një mënyrë për ta frenuar valën e gënjeshtrave



Megapolisi i turbullt dhe i ndotur me smogun e dezinformatave: Pamje nga filmi Vrapuesi në Teh [Blade Runner], me aktorët William Sanderson (majtas) dhe Daryl Hannah (foto: Moviestore/Shutterstock)

Nga: Peter POMERANTSEV / *The Guardian*

Në vitin 1996, John Perry Barlow – ish-tekstshkruesi i grupit Grateful Dead dhe një guru i idealistëve hipi-teknikë në Luginën e Silikonit – e shkroi një manifest emocional utopik, për të ardhmen e internetit. Duke iu drejtuar udhëheqësve të rendit botëror – të mbledhur në Davos – ai deklaroi:
Qeveritë e botës industriale, ju gjigantë të përgjumur të bërë nga mishi dhe nga çeliku, unë vij nga hapësira kibernetike, nga shtëpia e re e mendjes … Në hapësirën kibernetike do ta krijojmë qytetërimin e mendjes. Qoftë më human dhe më të drejtë se bota e krijuar më parë nga qeveritë tuaja.
Njëzet e tre vjet më vonë, kjo fantazi utopike është zëvendësuar me internetin që i ngjan më shumë Vrapuesit në Teh [filmi Blade Runner – shën. i përkth.]: megapolisit të turbullt e të ndotur me smogun e dezinformatave; ku ëndrrat për liri janë kthyer në nivele të paprecedenta të vëzhgimit; të sunduar nga një grup i vogël i mega-korporatave të papërgjegjshme të cilat vështrojnë qytetin e internetit duke i shfrytëzuar subjektet e veta të çorientuara, të pafuqishme dhe të zemëruara – që të njëjtën kohë janë përdoruesit e tyre që varen nga ta dhe produkte prej të cilave ata i thithin të dhënat për t'i bërë të fuqishmit edhe më të paprekshëm.
Tema kryesore e Vrapuesi në Teh është lufta për ta bërë dallimin mes njerëzve të vërtetë dhe "replikantëve" – robotëve që imitojnë njerëzit. Në internetin e sotëm të Vrapuesit në Teh, gjithashtu përpiqemi ta analizojmë të vërtetën dhe gënjeshtrën, pasi botat dhe llogaritë e rreme bëjnë bashkë mediat sociale duke pretenduar se janë njerëz të vërtetë, duke e shtrembëruar ndjenjën tonë të realitetit. Këta replikantë të internetit mund të përdoren për ta sulmuar një armik, ose – në mënyrën më tinëzare – për të bërë temën margjinale që të tingëllojë si temë qendrore.
Siç kanë dëshmuar dekadat e kërkimeve studimore për komunikimin, njerëzit priren t'i adoptojnë mendimet që ata mendojnë se janë të zakonshme, atë që studiuesi i internetit, Samuel Woolley, e quan "konsensus prodhimi". Falsifikimi i llogarive të mediave sociale çon jo vetëm në mashtrimin e përdoruesve individualë, por në një shoqëri që humbë kontaktin me atë që mendon në të vërtetë, e ku ajo që "mendon me të vërtetë" mund të riprogramohet.
Në një diskurs që mund të shtrembërohet kaq lehtë, është gjë joshëse të heqësh dorë nga çdo shpresë për sferën publike demokratike, ku idetë dhe dëshmitë peshohen, debatohen dhe vendosen nga qytetarët e vërtetë, dhe ku një person e ka një zë. Kjo është sfida për gjënë kryesore të demokracisë si model qeverisjeje. Mesazhi i diktaturave të sotme digjitale, nga Kina e deri te Arabia Saudite, është se demokracia nuk mund të përballet me dimensionin e internetit dhe, në këtë konfuzion, më mirë është që liria të dorëzohet ndaj zgjedhjes së fuqive të centralizuara që i përdorin të dhënat tona për t'i marrë vendimet për ne.
Në lagjet e varfra të mediave sociale dhe në rrugicat e rrjetave të errëta të internetit tonë të Vrapuesit në Teh, i takoni tregtarët e këqij të shërbimeve gjysmë të ligjshme dhe plotësisht të paligjshme për t'ju ndihmuar që ta menaxhoni këtë lojë që shtrembëron realitetin për dobinë tuaj. Ata shesin bot-netët dhe shërbimet e hakerimit, teknologjitë e mbikëqyrjes dhe të deponimit të të dhënave. Si çdo shitës i dyshimtë, ua premtojnë ëndrrat joshëse për fitoren e paverifikueshme. Me çmimin e duhur pretendojnë se e kanë "salcën magjike" për t'jua fituar zgjedhjet, për ta manipuluar sjelljen e armiqve tuaj, për ta falimentuar biznesin e rivalëve tuaj.
Ekipi Horhe [Team Jorge që ka manipuluar 33 zgjedhje presidenciale në mbarë botën, duke ia dalë mbanë në 27 raste të tilla – shën. i përkth.], një njësit izraelit i operacioneve të zeza në internet i zbuluar nga ditorja Guardian dhe nga partnerët e saj përmes një operacioni mahnitës, është pjesë e një industrie krejtësisht të çuditshme (ekipi e mohon përgjegjësinë).
Në librin tim të fundit, Kjo nuk është propagandë [This is Not Propaganda] takova shumë dilerë të tillë të dezinformatave, nga Manila deri në Meksiko-Siti. Kam qenë gjithmonë i habitur me mënyrën se si ata e arsyetonin veten. Të gjithë ishin amoralë – për këtë lojë duhej të ishe i tillë. Shumica ishin jabanxhinj që kishin ardhur në qytetin e madh, për t'ia dalë mbanë, dhe historitë e tyre i panë thjesht në aspektin e një djali të vogël nga provinca që luan me lojën e përcaktuar nga të tjerët. Disi, punën e tyre të pistë e bënin të tingëllojë si diçka heroike. Të gjithë ranë dakord se ata nuk i vendosën rregullat. Ky ishte faji i politikanëve dhe bizneseve të mëdha që kontrollojnë qytetin e internetit dhe i klientëve që paguanin. Nëse ata nuk do t'i ofronin këto shërbime, dikush tjetër do t'i ofronte.
Dhe, gjëja e trishtueshme është se në këtë aspekt ata kanë ku të kapen. Çfarë do të ndodhë tani që Horhe është dënuar? Kompanitë e teknologjisë do të përmbysin llogaritë e veta replikante, rregullimin e hanzaplastëve ngjitës kundër "sjelljes së koordinuar joautentike". Por, fakti brutal është se krejt mënyra se si janë ndërtuar platformat, a priori është një shfrytëzim i qytetarëve dhe njëkohësisht gjë e lehtë për t'u shfrytëzuar nga akterët e këqij. Është sistem i ndërtuar mbi mbikëqyrjen dhe thithjen e të dhënave të njerëzve, për t'i manipuluar ata; ku qytetarët nuk kanë asnjë kontroll dhe madje as nuk i kuptojnë algoritmet që diktojnë atë që ne shohim dhe më pas ndiejmë dhe që në fund e bëjmë në internet. Horhe nuk është defekt, është tipar i internetit tonë aktual.
A mund ta paramendojmë një internet tjetër, një internet që në fakt u krijua për ta përforcuar demokracinë? Ky është ushtrimi që ne e zhvilluam si pjesë e Projektit të Uebit të Mirë [Good Web Project] të drejtuar nga njësia ime në Universitetin Xhon Hopkins [Johns Hopkins] dhe nga thinktanku Demos. Interneti i tillë do t'i lejonte njerëzit të jenë anonimë kur kjo është e rëndësishme për sigurinë e tyre (anonimiteti është e drejtë), por do të kishte sisteme që bëjnë me dije se llogaritë në internet do të lidhen me njerëzit e vërtetë: do të ishte i qartë ndryshimi mes njerëzve dhe replikantëve. Do të ishte një internet që do të kishte hapësira të drejtuara për të mirën e komunitetit, jo për interesat private.
Do t'i kishim debatet tona politike në hapësirat e krijuara për ta dëgjuar sidomos njëri-tjetrin, për t'i peshuar provat, për të marrë vendime. Rrjetet [si Facebook dhe Twitter] mund të jenë vende të mira për t'u shfryrë apo për t'u mburrur, por ato nuk janë projektuar për t'i përcaktuar politikat apo për t'i përpunuar vizionet për të ardhmet e përbashkët.
Është i mundur qyteti i tillë i ri i internetit. Në vend të qytetit keqdashës të Vrapuesit në Teh, ku gjithçka është në pronësi të kompanive shfrytëzuese me abdomenin e banditëve të internetit, do të kishte ekuivalentin digjital të parqeve publike, bibliotekave, bashkive. Por, tani ne nuk jemi askund afër kësaj.
Pra, a mund të mbijetojmë sot? Çfarë mund të bësh nëse je, për hir të argumenteve, aktivist që dëshiron të minojë mobilizimin e luftërave gjenocidale të Rusisë? Apo kur e drejton një fushatë për të përçarë të djathtën ekstreme në Evropë? Apo narko-dilerët në Amerikën Latine? Do të prisni për internetin e ri? Nuk kemi kohë për këtë. Jo, do të shkoni në rrugicat e errëta të internetit tonë të Vrapuesit në Teh dhe do ta kërkoni një Horhe. / *Përkthimi: Agron Shala - Telegrafi.com*




Sport


Veton Zymberi, redaktor i sportit

# Ballkani nuk gabon në 'Riza Lushta', Llapi fiton ndaj Dukagjinit

Ballkani dhe Llapi kanë rrëmbyer nga tri pikë në ndeshjet e zhvilluara si mysafirë në Mitrovicë dhe Klinë ndaj Trepçës '89 dhe Dukagjinit. Ballkani kryeson në tabelë me tri pikë më shumë se Drita, kurse Llapi është ngritur në vendin e katërt

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHKURT - Të enjten janë zhvilluar edhe dy ndeshjet e fundit të javës së 21-të në Superligën e Kosovës në Futboll. Fitoreve u janë gëzuar Ballkani dhe Llapi, pasi triumfuan ndaj Trepçës '89, përkatësisht Dukagjinit. Ballkani është rikthyer në vendin e parë pas fitores së vështirë në përballje me Trepçën '89. Skuadra nga Suhareka fitoi me rezultat 0-1 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë, ndërsa golin e fitores e realizoi sulmuesi Albion Rrahmani dy minuta para përfundimit të kohës së rregullt. Pas kësaj fitore Ballkani vazhdon kryesimin në elitë me 47 pikë, tri pikë larg Dritës e cila është në vendin e dytë.
89-shi është i shtati me 22 pikë. Në takimin tjetër, Llapi ka shënuar fitore në ndeshjen kundër Dukagjinit. Edhe Llapi fitoi me rezultat minimal 0-1 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "18 Qershori" në Klinë. Golin e fitores për llapjanët në minutën 12 e shënoi Festim Alidema. Llapi pas kësaj fitore është ngritur në pozitën e katërt me 29 pikë, kurse Dukagjini është i gjashti me 25 pikë të grumbulluara.



Ndërsa të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje. Drita e ka fituar ndeshjen derbi me Prishtinën me rezultat 1-2. Për kryeqytetasit shënues ishte Jalen Aleix Blesan, kurse për gjilanasit shënuan Besnik Krasniqi nga penalltia dhe Blend Baftiu. Në ndeshjen tjetër Gjilani e mposhti Drenicën me rezultat 2-1. Golat e fitores për gjilanasit i realizuan Kelmendi dhe Zabërgja, ndërsa për kuqezinjtë Dervishaj. Pikët i ndanë Malisheva dhe Ferizaj, që mbetën 1-1.

SUPERLIGA - Xhiroja 21

| | |
|---|---|
| Trepça '89 - Ballkani | 0-1 |
| Dukagjini - Llapi | 0-1 |
| Prishtina - Drita | 1-2 |
| Malisheva - Llapi | 1-1 |
| Drenica - Gjilani | 1-2 |

Tabela

| | |
|---|---|
| 1. Ballkani | 47 pikë |
| 2. Drita | 43 |
